

DETYRE PROJEKTIMI FAZA V - VI

NDËRHYRJE PËR NGRITJEN E PRODUKTEVE TURISTIKE NË ZONAT E REJA ME POTENCIAL ZHVILLIMI

RAJONAL DHE LOKAL, “BOOTCAMP”, RESORTE EKO, KAMPINGJE, SKI RESORT, ETJ.

Nënobjekti: Zona e Eco Park Dumrea në Belsh – Pasurim me funksione të reja “Park Social Edukativ dhe Kulturor në funksion të fëmijëve” Eco Park Dumrea – Belsh

Kontraktori do të realizoj të gjitha proceset e punës të nevojshme për të bërë të mundur realizimin e objekteve të plota funksionale, në formë, sipërfaqe dhe volume në përputhje me standardet e ndërtimit për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në projektet teknike të miratuara, duke përfshirë proceset e mëposhtme por jo vetëm:

- Përgatitja e projektit të zbatimit dhe preventivit përfundimtar, Faza V dhe VI sipas VKM 354 datë 11/05/2016 në përputhje me Projektin Teknik. Marrja e opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit (IN);
- Përgatitja dhe plotësimi i dokumentacionit për zbardhjen e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me aplikimin e kryer në Bashki;
- Përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e të gjithë procedurës së nevojshme për lidhjen me infrastrukturën (furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, lidhja me rrjetin KUZ);

Faza V: Projekti i zbatimit

a) Projekti do të zhvillohet me tej dhe ndërtohet në përputhje me Projektin Teknik, vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen projektet e arkitekturës, bazuar mbi funksionet e projekti i strukturës, projekti i rrjeteve të instalimeve elektrike, projekti i instalimeve hidromekanike, projekti i instalimeve mekanike të MNZ-se dhe instalimeve të tubacioneve për sistemet ngrohje-ftohje, infrastrukturave ndihmëse, sistemeve të jashtme, etj. Projektet e vëna në dispozicion janë pjesë integrale e ofertës dhe kontratës, përfshirë, vizatimet, raportet, relacionet, specifikimet teknike, etj.

Theksojmë që në të gjitha rastet ndryshimet që mund të ndodhin në raport me projektin e dhënë nga autoriteti kontraktor, duhet të marrin miratimin e tij në fazën e përfundimit të projektit të zbatimit të hartuar nga operatori ekonomik.

b) Përpunim dhe detajim i punës (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur), funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjetic (p.sh. efikasiteti i energjisë, përdorimi i burimeve energjeticë të rinovueshme) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt,

nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.

c) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.

d) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve dhe tabela krahasuese me sipërfaqet dhe numrin e apartamenteve sipas përcaktimeve të PDYV-se.

Arkitektura

- 1) Plansistemi i objektit, gjelberimi dhe ndricimi i jashtëm, prerje, detaje (Gjelberimi, rrethimi, shtresa, mobilimi urban, ndricimi, etj)
- 2) Planvendosja e objektit sipas planit territorial dhe përputhshmëria me VKM 408
- 3) Rilevim topografik të zonës dhe pronës në të cilën do të ndërtohet objekti
- 4) Planimetritë e objektit sipas funksioneve (me mobilim)
- 5) Planimetritë e objektit (me dimensione, kuota dhe detaje shtresash)
- 6) Planimetria e propozuar e teracës /çatisë, kullimit të ujrave (me dimensione, kuota dhe detaje shtresash)
- 7) Prerjet (me kuota e dimensione) dhe detajet
- 8) Fasadat me specifikime sipas veshjes dhe të dritareve e ballkoneve, elementeve të strehëve dhe konsolave, (me kuota e dimensione) dhe detajet elemente arkitektonike të fasadës
- 9) Plani i mobilimit
- 10) Tabela dritare
- 11) Detajet e shtresave veshëse të kateve, shtresave të teracës/çatisë
- 12) Skema e qarkullimit horizontal dhe vertikal dhe plani i evakuimit si edhe skema PAK

Konstruksioni

- 1) Plan organizimi i punimeve
- 2) Plani i piketimit,
- 3) Plani i themeleve, prerjet dhe detaje
- 4) Strukturat mbajtëse e armimi i tyre (se bashku me tabelat e hekurit)
- 5) Plani i strukturave mbajtëse të kateve, prerje dhe detaje të tyre
- 6) Plani i strukturave të propozuara të teracës
- 7) Soletat e propozuara të kateve, armimi, prerje dhe detaje
- 8) Soleta/kapriata e çatisë, armimi, prerje dhe detaje
- 9) Detaje të tjera konstruktive dhe përlogaritja e strukturave mbajtëse.

Projekti elektrik dhe i ndriçimit dhe TIK

- 1) Planimetritë, prerje e detaje të instalimeve të rrjetit elektrik dhe TIK të

- kateve dhe te ambjenteve te jashtme (nese ka)
- 2) Planimetritë, prerje e detaje te ndriçimit të brendshëm e të jashtëm
 - 3) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve të rrjeteve te

tjera Projekti hidro-mekanik

- 1) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve të rrjetit hidro-sanitar të kateve
- 2) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve mekanike ne skemat horizontale dhe vertikale
- 3) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve të rrjetit HVAC (ngrohje, ventilim, kondicionim) ne skemat horizontale dhe vertikale
- 4) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve të mbrojtjes ndaj zjarri ne skemat horizontale dhe vertikale) ne skemat horizontale dhe vertikale
- 5) Planimetritë, prerje e detaje te instalimeve per lidhjen me rrjetin e Infrastrukt

RAPORTET

- 1) Raporti Teknik (arkitekture, konstruksio, elektrike, hidraulike, etj se bashku me llogaritjet perkatese sipas disiplinave dhe fushave te projektit)
- 2) Studimi Topografik
- 3) Studimi Gjeoteknik
- 4) Studim Hidrologjik
- 5) Studim Gjeologjik-Inxhinjerik + Harta gjeologjike së bashku me planimetrinë, së bashku me detajet gjeoteknike të disponueshme
- 6) Raporti i Shpronësimeve dhe hartat perkatese (nese ka)
- 7) Specifikimet Teknike sipas disiplinave te projektit.
- 8) Raporti i Audit per Eficence e Energjise

Faza VI: Preventivi përfundimtar

- 1) Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.
- 2) Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e ofertuar.

Stafi mbështetës

Referuar Nenit 39 pika 1/b e VKM nr.285/2021

1. Punët publike mund të prokurohen:

b) me kontratë me çelësa në dorë:

i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron. Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratë

1 (nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, b-2, d: për projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike; Qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore, Projektim peizazh, sistemime sipërfaqe te gjelbera, lulishte e parqe.)

1 (nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a,b-2: për projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate; Objekte me skelet metalik)

1 (nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,f,j: për projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; Projektim të sistemeve kundra zjarrit; Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza V-VI).

Kohezgjatja

Dorezimi i projektit të zbatimit duke përfshirë të gjithë dokumentacionin e sipërcituar, dhe jo vetëm, duhet të realizohet brenda një afati kohor prej 8 jave duke përfshirë dhe komentet nga AK.